



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT
DREJTORIA E PROKURIMIT PUBLIK**

Data 06/10/2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Sherbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “SHPENZIME PËR SIGURACIONIN E MJETEVE TË
TRANSPORTIT”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Shërbime sigurimi – 98341140-8**

VLERA E FONDIT LIMIT:

1,096,067.33 (një milion e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëdhjetë e shtatë pikë tridhjetë e tre) lekë pa Tvsh. Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”.

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; perkatesisht në vleren: **21,921.34 (njëzet e një mijë e nëntëqind e njëzet e një pikë tridhjetë e katër) lekë** të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se:

“...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”

“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencën si dhe Aneksin e Licencës, për Ushtrimin e Veprimtarisë së Sigurimit të automjeteve të lëshuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, për të provuar ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1, gërma a, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41 pika 4/a” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Kërkesa sipas pikës 2.3.1 është përcaktuar dhe në referencë të Ligjeve specifike të Ligjit Nr.32/2021 “Per Sigurimin e Detyrueshem ne Sektorin e Transportit” dhe Ligjit Nr.52/2014 “Për veprimtaritë e sigurimit dhe risigurimit” mbi bazen e të cilit rregullohet krijimi, veprimtaria dhe mbikëqyrja e shoqërive të sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit, me qëllim që tregu i sigurimeve të veprojë në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të konsumatorit.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se janë të regjistruar dhe të liçensuar për kryerjen e veprimtarisë në fushën e sigurimit të automjeteve me qëllim realizimin e kontratës konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për sigurimin e detyrueshem të mjeteve të transportit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% vlerës e fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa 40 % vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar në të cilin përcaktohet se:

”1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës.

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedure e Hapur e thjeshtuar” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 ”Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe Kreut II ”Kufijtë monetarë” të VKM nr. 291, datë 15.05.2024 ”Për përcaktimin e kufijve monetare në procedurat e prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 43

Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklarave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...;

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;

KREU II

KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK

1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) *Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;*

b) *Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.*

Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit duke ju referuar përcaktimeve të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohet deri në tre vitet e fundit financiare, si dhe nisur nga përcaktimi i pikës 7 të e Rekomandimit të APP Nr.7998 datë 24.12.2021 "Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime" ku përcaktohet se në nenin 19 të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese deklarohet në organe tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet në korrik të vitit 2025 dhe tatimpaguesit kanë afat deri më 31 mars 2025 të deklarojnë xhiron e realizuar në vitin 2024 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2022, 2023 dhe 2024.

Lidhur me vlerën e xhiros vjetore të përcaktuar, meqënëse procedura e mësipërme e prokurimit është nën kufirin e ulët monetar u përcaktua që vlera e xhiros vjetore të jetë sa 40% e vlerës së fondit limit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c) të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga

veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumë prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Njesisë së Qeverisjes Vendore ku operatori ekonomik ka selinë.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. *Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, germa b të LPP, i ndryshuar si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2025 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

2.3 Për kapacitetin teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate konkretisht: **21,921.34(njëzet e një mijë e nëntëqind e njëzet e një pikë tridhjet e katër) lekë pa Tvsh.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për shërbime të mëparshme të ngjashme të realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të ngjashme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4, germa (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të fondit limit për këtë lot. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2 Licenca profesionale dhe CV të stafit kryesor përgjegjës për zbatimin e kontratës:

- Shoqëria e sigurimit duhet të ketë pjesë të stafit të tij minimalisht një vlerësues dëmsh në sigurime të licencuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, sipas parashikimit të kuadrit ligjor në fuqi. Për të vërtetuar këtë kriter Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Licencë e vlerësuesit të dëmit në sigurime (e vlefshme)
- Kontratë pune (e vlefshme)
- CV (curriculum Vitae)

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ a) dhe b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që kontraktuesi duhet të përcaktojë një person të licencuar nga AMF për vlerësimin e dëmeve i cili referuar rregullores së miratuar me Vendimin e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare nr. 53, datë 25.06.2009 në çdo rast të shkaktimeve të dëmeve materiale duhet të kryejë akt ekspertimin e dëmit në vendndodhje në prani dhe të palës së dëmtuar ose të përfaqësuesit të tij. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e veçanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, licenca etj janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se eksperti është operativ pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Pra sa më sipër bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, dhe legjislacionit specifik për sigurimin e mjeteve motorike dhe trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontratat e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës ekspert të licencuar për vlerësimin e dëmeve.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike/termat e references janë hartuar duke u bazuar në parametrat e lejuara dhe sipas standardeve në fuqi, të cilat përbushin kërkesat dhe nevojat e AK nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike, për mallrat/shërbimet objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat/ shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38 dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

3. Specifikimet teknike

3.1 Objekti

Objekt i kësaj kontrate është sigurimi i përgjegjësisë të drejtuesit të mjetit motorik për demet që ky drejtues mund t'i shkaktojë palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti, në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar dhe Rregullores nr. 53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, (i ndryshuar).

Kjo kontrate sigurimi mbulon përgjegjësinë e të siguruarit ndaj palëve të treta për dëme të ndodhura vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në territoret e shteteve të tjera me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje.

Sigurimi i detyrueshëm në sektorin e transportit

Mbulimi

Sigurimi i detyrueshëm në sektorin e transportit (MTPL) është i rregulluar nga Ligji 32 /2021, dhe përse i përket mjeteve motorike, mbulon:

- a) sigurimin e përgjegjësisë së pronarit/përdoruesit të mjetit motorik për dëmet e shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti;
- b) sigurimin e pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik;

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare miraton rregullat për përcaktimin e kushteve të përgjithshme të sigurimit të detyrueshëm, ndërsa shoqëria e sigurimit përcakton vetë tarifat e primit të sigurimit, duke marrë parasysh faktorët e riskut, dhe fillon t'i zbatojë ato, pasi njofton zyrtarisht AMF.

Në kuadër të ligjit “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” çdo automjet që qarkullon brenda territorit të Republikës së Shqipërisë duhet të jetë i pajisur me policën e sigurimit TPL (Sigurimi i Detyrueshëm i Mbajtësit të Mjetit Motorik për Përgjegjësinë Civile ndaj Palëve të Treta). Përmes këtij produkti mbulohen përgjegjësinë civile të mbajtësit të mjetit motorik, në përputhje të plotë me parashikimin e Ligjit.

Ky sigurim përfshin mbulimin e shpenzimeve si pasojë e dëmeve materiale, shëndetësore dhe pasurore të shkaktuara ndaj palëve të treta, për shkak të qarkullimit të mjetit motorik të siguruar.

3.2 Procedura dhe afatet për dëmshpërblim

Përfituesi ose pala e dëmtuar, ka të drejtë të paraqesë kërkesën për dëmshpërblim të siguroesit, përgjegjës i pronarit të mjetit, me të cilin është shkaktuar aksidenti. Siguroesi përgjegjës është i detyruar të trajtojë kërkesën për dëmshpërblim dhe të kryejë njoftimin përkatës, sipas pikës 1 të këtij neni, brenda afateve të mëposhtme:

- a) për dëme jo pasurore, brenda 90 ditëve nga data e plotësimit të dokumentacionit, që shoqëron kërkesën për dëmshpërblim;
- b) për dëme pasurore, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për dëmshpërblim.

Në përfundim të trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim, në rast pranimi të kërkesës, shoqëria e sigurimit duhet të njoftojë palën e dëmtuar për masën e dëmshpërblimit të vlerësuar prej saj.

Shoqëria e sigurimit kryen pagesën e dëmshpërblimit brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve kalendarike pas përfundimit të afatit të trajtimit të dëmit dhe nënshkrimit të deklaratës së

pranimin të dëmshpërblimit. Në rast të mosrespektimit të afatit të përcaktuar në këtë nen, palës së dëmtuar i lind e drejta e përfitimit të interesit të pagueshëm për çdo ditë kalendarike vonesë në shlyerjen e dëmshpërblimit nga shoqëria e sigurimit.

Në rastet kur kërkesa e paraqitur nuk është e plotë, shoqëria e sigurimit i drejtohet kërkuarit me shkrim brenda 8 (tetë) ditëve kalendarike pas pranimin të kërkesës dhe kërkon plotësimin e dokumentacionit.

Në përfundim të trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim, në rast refuzimi të kërkesës, shoqëria e sigurimit duhet të njoftojë me shkrim palën e dëmtuar për refuzimin dhe shkaqet ligjore, që çojnë në këtë refuzim.

Pala e dëmtuar, me marrjen e njoftimit, ka të drejtën e ankimimit pranë shoqërisë së sigurimit. Shoqëria e sigurimit është e detyruar t'i përgjigjet ankimit të palës së dëmtuar brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së ankimit.

Në rast se shoqëria e sigurimit nuk i përgjigjet palës së dëmtuar brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, dhe/ose pala e dëmtuar nuk është dakord me masën e dëmshpërblimit të ofruar nga shoqëria e sigurimit dhe/ose pala e dëmtuar nuk është dakord me 7 shkaqet e refuzimit të dëmshpërblimit nga shoqëria e sigurimit, vetëm në këto raste pala e dëmtuar ka të drejtë të ngrejë padi civile kundër shoqërisë së sigurimit.

3.3 Kontratat e sigurimit të detyrueshëm

Për mjetet në transportin publik, siguroesi nuk lëshon kontratën e sigurimit të përgjegjësisë së pronarit nëse pronari i mjetit nuk zotëron edhe policën e sigurimit të pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik, sipas përcaktimeve të nenit 17 të këtij ligji.

4. Kontrata e sigurimit duhet të përmbajë:

- a) emrat dhe adresat e palëve;
- b) objektin e kontratës;
- c) rrezikun e mbuluar dhe përjashtimet ose kufizime të tjera të mbulimit;
- ç) mënyrën dhe rastet e rinovimit, të ndryshimit të kontratës;
- d) mënyrat e zgjidhjes së plotë apo të pjesshme të kontratës;
- dh) detyrimet e palëve dhe pasojat juridike të mospërmbushjes së tyre;
- e) mënyrën dhe afatet për pagesën e dëmshpërblimit, si dhe pasojat e mospagimit ose pagimit të pasaktë nga ana e shoqërisë së sigurimit;
- ë) primin e sigurimit;
- f) kushtet e pagesës së primit dhe pasojat e mospagimit;
- g) në rastin e nënshkrimit të kontratës nga ndërmjetësi, emrin, adresën dhe të dhëna të licencës së ndërmjetësit, si dhe kodin e identifikimit të tij;
- gj) datën dhe vendin e nënshkrimit të kontratës;
- h) detyrimet e të siguruarit në rast të ndodhjes së ngjarjes së siguruar dhe barra e tij e provës;
- i) trajtimin e shërbimeve të siguroesit;
- j) trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim për rastet që trajtohen nga Byroja dhe shoqëritë e sigurimit, si ent kompensues.

5. Kushtet e kontratës së sigurimit përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet ndërmjet palëve kontraktuese, përveç atyre të parashikuara në këtë ligj.

6. Kontrata e sigurimit të detyrueshëm bëhet me shkrim në formën e policës së sigurimit dhe është e vlefshme edhe në rastet kur është në formën e një dokumenti elektronik në përputhje me dispozitat e ligjit për nënshkrimin elektronik dhe për dokumentin elektronik.

3.3 Kufiri minimal i përgjegjësisë

Kufiri minimal i përgjegjësisë, që mbulohet nga kontrata e sigurimit, për një ngjarje është si më poshtë:

Kufiri minimal i përgjegjësisë, që mbulohet nga kontrata e sigurimit, për dëme të shkaktuara në territorin e Republikës së Shqipërisë është si më poshtë:

a) për dëme pasurore dhe jopasurore, me pasojë vdekjen, dëmtime shëndetësore dhe përkeqësime të shëndetit, të shkaktuara nga një aksident ose seri aksidentesh të ardhura nga një ngjarje sigurimi për:

- i. autobusë dhe kamionë, përfshirë rimorkiot, 150 000 000 lekë;
- ii. mjete që transportojnë lëndë të rrezikshme 200 000 000 lekë;
- iii. mjete të tjera, përfshirë mjetet e paidentifikuara, 55 000 000 lekë.

b) për dëme të lidhura me dëmtimin ose shkatërrimin e pronës nga një ngjarje:

- i. për autobusë dhe kamionë, përfshirë rimorkiot, 20 000 000 lekë;
- ii. për mjete që transportojnë lëndë të rrezikshme 20 000 000 lekë;
- iii. për mjete të tjera, përfshirë mjetet e paidentifikuara, 15 000 000 lekë

3.4. Primi i riskut per TPL e brendshme

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, AMF mbi bazën e të dhënave të shoqërive të sigurimit, llogarit primin e rrezikut në nivel tregu për produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik brenda datës 31 mars të çdo viti pasardhës.

Tabelat e primit të rrezikut shoqërohen me një raport aktuarial i cili përmban:

- vlerësime mbi profilin e rrezikut të çdo produkti dhe tendencat e shfaqura;
- vlerësime për dëme të mëdha dhe tendencat;
- metodën statistikore të përdorur në llogaritjen e demit mesatar të rregulluar;
- frekuencën e dëmeve të rregulluara;
- normën e pritshme të inflacionit të përgjithshëm dhe atij të produktit;
- koeficientin e pritshëm për fondin e kompensimit;
- metodat statistikore dhe aktuariale të përdorura në vlerësimin e çdo elementi tjetër të primit të rrezikut, përfshirë këtu gjykimet mbi efektin moral, biologjik dhe ekzistencial.

Elementët përbërës të primit të sigurimit janë:

- **Primi i riskut** është pjesa e primit të sigurimit që paguan i siguruari për mbulimin e përgjegjësisë për dëme që mund të shkaktoje në të ardhmen sipas parashikimeve në kontratën e sigurimit.
- **Ngarkesat mbi primin e riskut:** pjesa e llogaritur për mbulimin e shpenzimeve të marrjes në sigurim dhe shpenzimeve administrative, përfshirë dhe komisionet;
- pjesa e llogaritur për **fitimin** e shoqërisë së sigurimit.
- **Primi final** që paguan i siguruari përfitohet duke i shtuar primit të sigurimit taksat dhe kontributet.

Afati i primit të sigurimit (periudha e sigurimit) 12 muaj nga data e lëshimit të siguracionit për çdo mjet.

